

**Rekomandimet e Oslos
Lidhur me të Drejtat Gjuhësore
të Pakicave Kombëtare
& S qarime**

shkurt 1998

ISBN 90 – 7598904 - 0

Zyra e Komesarit të Lartë për Pakica Kombëtare
Prinsessegracht 22
2514 AP Hagë
Tel: +31 70 312 5500
Fax: +31 70 363 5910
E-mail: hcnm@hcnm.org

HYRJE

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) me Vendimet e saj të Helsinkit nga qershori i vitit 1992, e themeloi postin e Komisarit të Lartë për Pakicat Kombëtare i cili do të jetë “një instrument për parandalim të konflikteve mundësisht në fazën më të hershme”. Ky mandat u krijua kryesisht si reagim ndaj situates në ish Jugosllavi nga e cila u paraqit frika se ajo mund të përsëritet dikund tjetër në Evropë, sidomos përmes shteteve në tranzicion kah demokracia, që do të kishte mundur të minojë paqën dhe prosperitetin siç është paraparë në Marrëveshjen e Parisit për Evropë të Re të miratuar nga Kryetarët e Shteteve dhe Qeverive në nëntor 1990.

Më 1 janar 1993, z. Max van der Stoel e mori detyrën si Komisar i Lartë për Pakica Kombëtare (KLPK) i pari në OSBE. Duke u nisur nga përvoja e tij e konsiderueshme personale si ish anëtar i parlamentit dhe Ministër i Punëve të Jashtme i Holandës, si përfaqësues permanent në Kombet e Bashkuara dhe një kohë të gjatë avokat për të drejtat e njeriut, z. Max van der Stoel e fokusoi vë mendjen e tij në mosmarrëveshjet e shumta mes pakicave dhe autoriteteve qëndrore në Evropë të cilat sipas qëndrimit të tij kishin potencial të eskalojnë. Duke vepruar qetë në mënyrë diplomatike, KLPK u inkuadrua në shtetet vijuese: Shqipëri, Kroaci, Estoni, Hungari, Kazakistan, Kirgistan, Lituani, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Rumani, Sllovaki dhe Ukrainë. Involvimi i tij është fokusuar kryesisht në ato situata që përfshijnë persona të cilët u takojnë grupeve nacionale/etnike dhe të cilët përbëjnë shumicën numerike në një shtet por pakicën numerike në shtet tjetër (kryesisht fqinjë) me ç’rast janë të prekura interesat e autoriteteve qeveritare në secilin shtet duke gjetur burimin potencial të tensionit në bile edhe konfliktit ndërshtetëror. Është e vërtetë se këto tensione kanë definuar në masë të madhe historinë e Evropës.

Në qasjen e esencës së tensioneve që involvojnë pakicat kombëtare, KLPK mirret me këtë çështje si veprimtar i pavarur, neutral dhe kooperativ. KLPK nuk është mekanizëm mbikqyrës dhe ai përdor standardet ndërkombëtare me të cilat është pajtuar çdo shtet duke analizuar bazamentin e rekomandimeve. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të përkujtohen të gjitha obligimet nga shtetet e OSBE-së, sidomos të atyre nga Dokumenti i Kopenhagës nga Konferenca mbi Dimenzionet Njerëzore më 1990, i cili në pjesën 4 i artikulon obligimet e detajshme lidhur me pakicat kombëtare. Është gjithashtu me rëndësi të ceket se të gjitha shtetet e OSBE-së janë të lidhura nga obligimet e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e

Njeriut, duke përfshirë të drejtat e pakicave dhe pjesa më e madhe e shteteve e OSBE-së janë të lidhura me standardet e Këshillit të Europës.

Pas aktivitetit intenziv pesëvjeçar, KLPK është aftësuar t'i identifikojë çështjet e caktuara që përsëriten dhe temat që janë bërë objekt i vemendjes së tij në një numër të shteteve në të cilat ai është involvuar. Të drejtat gjuhësore të pakicave kombëtare, si p.sh. e drejta e personave që u takojnë pakicave kombëtare të përdorin gjuhën e tyre në sferat publike dhe private, është një nga çështjet e lartpërmendura. Instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut i dedikohen kësaj të drejte në një numër të konteksteve të ndryshme. Nga njëra anë, gjuha është çështje personale ngushtë e lidhur me identitetin. Nga ana tjetër, gjuha është mjet qenësor për organizim social i cili në shumë situata bëhet çështje e interesit publik. Nënkuptohe, përdorimi i gjuhës mban në vehte aspekte të shumta të funksionimit të shtetit. Në një shtet demokratik që është dedikuar të drejtave të njeriut, përshtatja e dallimeve egzistuese kështu shëndrrohet në çështje të rëndësishme të politikës dhe ligjit. Paaftësia për të arritur baraspeshë adekuat mund të jetë burim i tensioneve ndëretnike.

Duke e pasë këtë parasysh, në verë të vitit 1996, KLPK kërkoi nga Fondacioni për Marëdhënie Ndëretnike të konsultojë një grup të vogël të ekspertëve të mirënjohur ndërkombëtar për të marrë nga to rekomandimet për zbatim adekuat dhe koherent të të drejtave gjuhësore të personave që u takojnë pakicave kombëtare në regjionin e OSBE-së. Një kërkesë e ngjajshme paraprakisht ka rezultuar nga KLPK në elaborimin e **Rekomandimeve të Hagës për të Drejtat e Shkollimit të Pakicave Kombëtare dhe Raporti Sqarues**. Meqenëse Rekomandimet e Hagës merren kryesisht me përdorimin e gjuhës ose gjuhëve të pakicave kombëtare në fushën e arsimit, u vendos që kjo çështje të tërhiqet nga fushëveprimi i ekspertëve.

Fondacioni për Marëdhënie Ndëretnike—organizatë kjo joqeveritare e themeluar në 1993 për t'i kryer aktivitetet e specializuara në përmbajtje të KLPK—mundësoi një varg konsultimesh nga ekspertë të disiplinave të ndryshme të rëndësishme, duke përfshirë dy takime në Oslo dhe një në Hagë. Në mesin e ekspertëve të konsultuar ishin juristë specialistë të së Drejtës Ndërkombëtare si dhe gjuhëtarë, avokatë dhe analistë të specializuar për situatat dhe nevojat e pakicave. Emrat e ekspertëve janë si vijon:

Profesor Gudmundur Alfredsson, ko-Drejtor, nga Instituti Raoul Wallenberg (Suedi); Prof. Asbjørn Eide, Docent në Institutin Norvegjez për të Drejtat e Njeriut (Norvegji); Angelita Kamenska, hulumtuese me përvojë, Qendra e Lituanisë për të Drejtat e Njeriut dhe Studime Etnike

(Lituanë); Dónall Ó Riagáin, Sekretar Gjeneral në Bironë Evropiane për Gjuhët më pak të Përdorura (Irlandë); Beate Slydal, Këshilltare, Forumi Norvegjez për Lirinë e të Shprehurit (Norvegji); Dr. Miquel Strubell, Drejtor, Instituti për Socio-linguistikë Katalane, Qeveria e Katalonisë (Spanjë); Prof. György Szepe, Departamenti për Shkenca Gjuhësore në Universitetin Janus Pannonius (Hungari); Prof. Patrick Thornberry, Departamenti i Drejtësisë, Universiteti Keele (Britani); Dr. Fernand de Varennes, Drejtor i Qendrës Pacifiko-Aziate për të Drejtat e Njeriut dhe Parandalimin e Konfliktit Ndëretnik (Australi); Prof. Bruno de Witte, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Maastricht-it (Holandë); Jean-Marie Woehrling, Instituti i Drejtësisë (Francë).

Meqenëse standardet egzistuese të të drejtave të pakicave janë pjesë e të drejtave të njeriut, pika fillestare për këto konsultime ishte mirëkuptimi i shteteve me të gjitha obligimet tjera për të drejtat e njeriut duke përfshirë, në veçanti, barazinë dhe lirinë nga diskriminimi, lirinë e të shprehurit, lirinë e tubimit dhe të asociacionit, si dhe të gjitha të drejtat dhe liritë që u takojnë pakicave kombëtare.

Gjithashtu u nënkuptua se lënda kryesore e të gjitha të drejtave të njeriut është zhvillimi i lirë i personalitetit njerëzor në kushte të barazisë. Rrjedhimisht, u paramendua se shoqëria civile duhet të jetë e hapur dhe fluide dhe të integrojë të gjithë personat duke i përfshirë edhe ata që u takojnë pakicave kombëtare. Meqenëse përdorimi i gjuhës është gjithashtu çështje fundamentale e komunikimit, plotësisht u parashikua edhe dimenzioni social i përvojës së njerëzve.

Rekomandimet rezultante të Oslos Lidhur me të Drejtat Gjuhësore të Pakicave Kombëtare tentojnë ta qartësojnë në gjuhë relativisht të kuptueshme përmbajtjen e të drejtave gjuhësore të pakicave kryesisht të aplikueshme në situatat ku është i involvuar KLPK. Përveç kësaj, standardet janë interpretuar në mënyrë për t'a siguruar koherencën e tyre në aplikim. Rekomandimet janë ndarë në nëntituj të cilët u përgjigjen çështjeve të lidhura me gjuhën të cilat paraqiten në praktikë. Sqarim më i detajshëm i Rekomandimeve është siguruar në Sqarimin shoqëruar ku mund të gjinden referenca për standardet relevante ndërkombëtare. Qëllimi është që çdo Rekomandim të lexohet në lidhshmëri me paragrafet relevante dhe specifike të Sqarimit shoqëruar.

Shpresohet se këto Rekomandime do të sigurojnë referencë të dobishme për zhvillimin e politikës dhe ligjeve të një shteti të cilat do të kontribuojnë në një

implementim efektiv të të drejtave gjuhësore të personave që u takojnë pakicave kombëtare, sidomos në sferën publike.

Edhe pse këto Rekomandime i dedikohen përdorimit të gjuhës nga personat që u takojnë pakicave kombëtare, duhet cekur se pjesa më e madhe e këtyre rekomandimeve dhe e instrumenteve ndërkombëtare nga të cilat ato rjedhin potencialisht mund të vlejnë edhe për lloje të tjera të pakicave. Rekomandimet që vijojnë më poshtë kanë për qëllim ta qartësojnë trupin egzistues të të drejtave. Ato nuk kanë për qëllim t'i kufizojnë të drejtat njerëzore të asnjë personi ose grupe personash.

REKOMANDIMET E OSLOS LIDHUR ME TË DREJTAT GJUHËSORE TË PAKICAVE KOMBËTARE

EMRA

- 1) Personat që u takojnë pakicave kombëtare kanë të drejtë të përdorin emrat e tyre personal në gjuhën e tyre, sipas traditave dhe sistemeve të tyre gjuhësore. Këto duhet të njihen zyrtarisht dhe të përdoren nga autoritetet publike.
- 2) Në mënyrë të ngjajshme, organizatat private siç janë asociacionet kulturore dhe ndërmarrjet e biznesit të themeluara nga persona që u takojnë pakicave kombëtare duhet ta gëzojnë të njëjtën të drejtë sa u përket emrave të tyre.
- 3) Në regjionet e banuara nga një numër të madh të personave që u takojnë pakicave kombëtare, kur egziston kërkesë e madhe, autoritetet publike duhet të sigurojnë emra lokal, emra të rrugëve si dhe tregues tjerë topografik në gjuhën e pakicave.

FEJA

- 4) Në shprehjen dhe përdorimin e fesë individualisht ose në bashkësi me të tjerët, çdo person ka të drejtë të përdorë gjuhën (gjuhët) sipas dëshirës të tij ose të saj.
- 5) Për ato ceremoni fetare ose dokumente që kanë të bëjnë me status të caktuar qytetar dhe që janë legale sipas ligjeve të shtetit në fjalë, shteti mund të kërkojë që certifikatat dhe dokumentet të lëshohen gjithashtu në gjuhën zyrtare ose në gjuhët e shtetit. Shteti mund të kërkojë që këto dokumente të mbahen nga autoritetet fetare gjithashtu në gjuhën zyrtare dhe në gjuhët e shtetit.

JETA NË BASHKËSI DHE ORGANIZATAT JOQEVERITARE (OJQ)

- 6) Të gjithë personat, duke i përfshirë dhe personat që u takojnë pakicave kombëtare, kanë të drejtë të themelojnë dhe të udhëheqin OJQ, asociacione dhe institucione të tyre. Këto trupa mund të përdorin gjuhët që ato i

zgjedhin. Shteti nuk guxon t'i diskriminojë këto trupa në baza gjuhësore e as që guxon pa arsye t'u shkurtojë të drejtën e të kërkojnë burime të veta për finansim nga buxheti shtetëror burime ndërkombëtare ose nga sektori privat.

- 7) Nëqoftëse shteti në mënyrë aktive sponsoron mes tjerash edhe aktivitete në sferën e kulturës dhe asj sociale, pjesë proporcionale të të gjitha të ardhurave të lejuara nga shteti duhet të përdoren për aktivitete të ngjajshme të organizuara nga persona që u takojnë pakicave kombëtare. Sponsorimi financiar shtetëror për aktivitetet që organizohen në gjuhën e personave që u takojnë pakicave kombëtare në këto sfera duhet bërë në baza jodiskriminuese.

MEDIUMET

- 8) Personat që u takojnë pakicave kombëtare kanë të drejtë të themelojnë dhe të mbajnë mediumet në gjuhën e tyre. Rregullat shtetërore për radiodifuzion duhet të bazohen në kritere objektive dhe jodiskriminuese dhe nuk duhet të përdoren për t'i kufizuar të drejtat e pakicave.
- 9) Personat që u takojnë pakicave kombëtare duhet të kenë mundësi të shfrytëzimit të kohës së emitimit në gjuhën e tyre në mediat shtetërore. Në nivele nacionale, regjionale dhe lokale sasia dhe kualiteti i kohës i caktuar për emitim në gjuhën e një pakice duhet të korespondojë me strukturën numerike dhe koncentrimin e pakicës kombëtare dhe po e njejta të jetë adekuate me rrethanat dhe nevojat e pakicës.
- 10) Natyra e pavarur e programeve të medimeve publike dhe private në gjuhët e pakicave duhet të jetë e garantuar. Këshillat drejtuese të mediave publike që e mbikqyrin përmbajtjen dhe orientimin e programit duhet të jenë të pavarura dhe duhet të përfshijnë persona që u takojnë pakicave kombëtare që do të ishin në cilësi të pavarur.
- 11) Ndikimi i jashtëm mbi mediat nuk duhet të kufizohet pa ndonjë shkak. Kjo nuk duhet t'a justifikojë zvoglimin e kohës së emitimit të caktuar në mediat shtetërore në shtetin ku jetojnë pakicat në fjalë.

JETA EKONOMIKE

- 12) Të gjithë personat, duke përfshirë edhe ata që u takojnë pakicave kombëtare, kanë të drejtë të udhëheqin ndërmarrje private në gjuhën ose gjuhët sipas dëshirës së tyre. Shteti mund të kërkojë përdorim plotësues të gjuhës ose gjuhëve zyrtare të shtetit vetëm aty ku egziston demonstrim i interesit legjitim publik, siç janë interesat që mbrojnë punëtorët ose konsumuesit ose në raportet mes ndërmarrjes dhe autoriteteve qeveritare.

AUTORITETET ADMINISTRATIVE DHE SHËRBIMET PUBLIKE

- 13) Në regjionet dhe lokalitetet ku personat që i takojnë pakicës kombëtare janë prezent në numër të madh dhe kur shprehin kërkesa, personat që i takojnë kësaj pakice kombëtare kanë të drejtë që t'u lëshohen dokumenta dhe vërtetime në gjuhën zyrtare ose gjuhët e shtetit dhe në gjuhën e pakicës kombëtare në fjalë prej institucioneve regjionale ose institucioneve lokale publike. Sipas parimit të njejtë, institucionet regjionale ose lokale publike duhet t'i mbajnë librat e caktuara amzë gjithashtu në gjuhën e pakicës kombëtare.
- 14) Personat që u takojnë pakicave kombëtare duhet të kenë mundësi adekuate ta përdorin gjuhën e tyre në komunikimet me autoritetet administrative sidomos në regjionet dhe lokalitetet ku është paraqitur ky interes dhe ku janë të pranishëm në numër të madh. Në mënyrë të ngjajshme, autoritetet administrative duhet të sigurojnë se shërbimet publike aty ku është e mundshme do të kryhen në gjuhën e pakicës kombëtare. Për këtë arsye ata duhet të sigurojnë kuadër adekuat ose programe për stërvitje të tyre.
- 15) Në ato regjione dhe lokalitete ku personat që u takojnë pakicave kombëtare janë të pranishëm në numër të madh, shteti duhet të ndërmerr masa që të sigurojë të drejtën e përfaqësuesve të zgjedhur qeveritar në njësitë regjionale dhe lokale si dhe të përdorin gjuhën e pakicës kombëtare në kryerje të aktiviteteve të lidhura me këto njësi qeveritare.

INSTITUCIONET E PAVARURA TE SHTETIT

- 16) Shtetet në të cilat jetojnë persona të cilët u takojnë pakicave kombëtare duhet të sigurojnë të drejtën e këtyre personave që krahas burimeve adekuate gjyqësore të mund të kenë lidhje edhe me institucionet e pavarura
-

të shtetit, siç është p.sh. Avokati Popullor ose Komisionet për të Drejtat e Njeriut në ato raste kur ata ndjejnë se u janë cënuar të drejtat gjuhësore.

AUTORITETET GJYQËSORE

- 17) Të gjithë personat, duke i përfshirë edhe personat që u takojnë pakicave kombëtare, për arsyet e burgosjes së tyre dhe mbajtjes në burg, si dhe për natyrën dhe arsyen e ndonjë akuze të ngritur kundër tyre, kanë të drejtë për informim të menjëhershëm në gjuhën të cilën e kuptojnë. Këta persona mund të mbrohen në gjuhën e tyre dhe ku është e nevojshme me ndihmën pa pagesë të përkthyesit.
- 18) Në regjionet dhe lokalitetet ku personat që u takojnë pakicës kombëtare janë të pranishëm në numër të madh, dhe nëqoftëse ata shprehin dëshirë që ta përdorin gjuhën e vet në procedurat gjyqësore ata duhet ta bëjnë këtë dhe po të ketë nevojë me ndihmën pa pagesë të ndonjë përkthyesi.
- 19) Në regjionet dhe lokalitetet në të cilët personat që u takojnë pakicës kombëtare jetojnë në numër të madh, shteti duhet të ketë kuptim të mjaftueshëm për anën praktike të kryerjes në gjuhën e tyre të të gjitha procedurave gjyqësore që i tangojnë këta persona.

PRIVIMI NGA LIRIA

- 20) Drejtori i ndonjë institucioni penal dhe personeli tjetër i po të njejtit institucion duhet ta flet gjuhën ose gjuhët e numrit më të madh të të burgosurve, ose ndonjë gjuhë që kuptohet nga shumica e tyre. Për këtë qëllim duhet të sigurohen kuadro të trajnuara ose programe për trajnim. Aty ku ka nevojë, mund të përdoren edhe shërbimet e përkthyesit.
- 21) Personat e burgosur që u takojnë pakicave kombëtare duhet të kenë të drejtë t'a zgjedhin gjuhën për komunikim. Autoritetet duhet aty ku është e mundshme, të ndërmarrin masa që t'u mundësojnë të burgosurve komunikim në gjuhën e tyre, në korespondimin gojor dhe personal në kuadër të kufizimeve të parashikuara me ligj. Në lidhje me këtë, i burgosuri kryesisht duhet të mbahet në burg afër vendit ku jeton.

SQARIME RRETH REKOMANDIMEVE TË OSLOS LIDHUR ME TË DREJTAT GJUHËSORE TË PAKICAVE KOMBËTARE

HYRJA E PËRGJITHSHME

Neni 1 i **Deklaratës Univerzale për të Drejtat e Njeriut** ka të bëjë me dinjitetin e lindur e të gjitha qenjeve njerëzore si koncept kryesor që nënvizon të gjitha standardet për të drejtat e njeriut. Neni 1 i **Deklaratës** thotë "të gjitha qenjet njerëzore janë të lindura të lira dhe të barabarta, me dinjitet dhe të drejta..." Rëndësia e këtij neni nuk mund të mbivlerësohet. Ai jo vetëm që ka të bëjë me të drejtat e njeriut në përgjithësi, por gjithashtu siguron një prej bazave për të drejtat gjuhësore të personave që u takojnë pakicave kombëtare. Barazia në dinjitet dhe të drejta parasupozon respekt të identitetit individual si qenje njerëzore. Gjuha është një prej komponentave qenësore të identitetit njerëzor. Nga kjo, respekti për dinjitetin e një personi është ngushtë i lidhur me respektin për identitetin e personit dhe rrjedhimisht me gjuhën e atij personi.

Në këtë kontekst, **Konventa Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike** ka rëndësi të veçantë. Neni 2 i **Konventës** kërkon nga shtetet të sigurojnë të drejtat e njeriut të gjithë individëve në kuadër të teritorit të tyre si dhe siguri dhe respekt "për të drejtat e tyre duke përfshirë edhe gjuhën". Neni 19 i **Konventës** e garanton lirinë e të shprehurit e cila, ashtu siç është formuluar në **Konventë**, jo vetëm që garanton të drejtën e këmbimit të informacioneve dhe ideve të çdo lloji, pa marrë parasysh kufizimet, por gjithashtu e garanton të drejtën që kjo të zhvillohet kështu në medime ose gjuhën e zgjedhur. Këmbimi i informacioneve gjithashtu u sugjeron njerëzve mënyrën e aktivitetit të tyre në bashkësi. Në këtë kontekst, neni 21 dhe 22 i **Konventës** duke i garantuar liritë e tubimeve dhe asociacioneve paqësore mund të ketë rëndësi të veçantë.

Në mënyrë të ngjajshme, në Evropë liria e të shprehurit e theksuar në nenin 10 të **Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave Njerëzore dhe të Drejtave Fundamentale** do të jetë, sipas nenit 14 të së njëjtës Konventë "e siguruar pa diskriminim në asnjë fushë siç është... gjuha..." Duke u nisur nga **Deklarata Univerzale për të Drejtat e Njeriut** dhe **Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale**, dhe **Deklarata për Lirinë e të Shprehurit dhe të Informuarit** e Këshillit të Evropës vërteton se "liria e të shprehurit dhe informacionit është e nevojshme për zhvillimin social, ekonomik, kulturor dhe politik të çdo qenie njerëzore, dhe kështu përbën kushtin për

përparim harmonik të grupeve shoqërore dhe kulturore, kombeve dhe bashkësisë ndërkombëtare”. Në lidhje me këtë, liritë e tubimit dhe asociacionit paqësor janë të rëndësishme meqenëse garantohen me nenin 11 të **Konventës Evropiane për Mbrojtjen e Njeriut dhe Lirive Fundamentale**.

Në kuadër të kontekstit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), të njejtat ide fundamentale për lirinë e të shprehurit, tubimit dhe asociacionit janë numëruar në paragrafet 9.1-9.3 të **Dokumentit nga Takimi i Kopenhagës për Konferencën e Dimenzionit Njerëzor**.

Në **Marrëveshjen e Parisit për Evropë të Re**, kryetarët e shteteve dhe qeverive të shteteve të OSBE-së “vërtetojnë se pa asnjë diskriminim, çdo individ ka të drejtën për:... lirinë e të shprehurit, lirinë për asociacion dhe tubim paqësor,...”

Neni 27 i **Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike** është çelës tjetër i rëndësishëm i cili drejtpërdrejt është i lidhur me të drejtat gjuhësore të pakicave kombëtare. Ai vërteton se “personat që u takojnë ... pakicave nuk do t’u mirret e drejta, në bashkësi me anëtarët tjerë të grupit të tyre, të... përdorin gjuhën e tyre”.

Ngjajshëm, neni 2(1) i **Deklaratës së KB për të Drejtat e Personave që u takojnë Pakicave Kombëtare ose Etnike, Fetare dhe Gjuhësore** proklamon të drejtën e personave që u takojnë pakicave kombëtare ta “përdorin gjuhën e tyre, privatisht dhe publikisht në mënyrë të lirë dhe pa ndërhyrje të ndonjë forme të diskriminimit”. Neni 10(1) i **Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare** të Këshillit të Evropës thekson se shtetet do ta njohin të drejtën e personave që u takojnë pakicave kombëtare “ta përdorin lirisht dhe pa pengesa gjuhën e tyre, privatisht dhe publikisht, gojarisht dhe me shkrim”.

Edhe pse këto instrumente e tregojnë nevojën e përdorimit të gjuhëve të pakicave publikisht dhe privatisht, po të njejtat nuk bëjnë ndarje precize të asaj se çka do të thotë “publike” përkundër sferave “private”. Këto sfera mund të përputhen. P.sh. kjo mund të ndodh kur individët vetë ose së bashku me të tjerët bëjnë kërkesë për të themeluar media ose shkolla të tyre private. Ajo që mund të fillojë si një iniciativë private mund të shëndërrohet në çështje të interesit legjitim publik. Ky interes mund të shkaktojë ndonjë rregullativë publike.

Përdorimi i gjuhëve të pakicave “publikisht dhe privatisht” nga personat që u takojnë pakicave kombëtare nuk mund të konsiderohet pa marrë parasysh edhe arsimin. Çështjet e shkollimit të lidhura me gjuhët e pakicave kombëtare janë trajtuar detajisht në Rekomandimet e Hagës që kanë të bëjnë me të drejtat e

shkollimit të pakicave kombëtare të zhvilluara për nevojat e KLPK të OSBE-së nga Fondacioni për Raporte Ndëretnike në bashkëpunim me ekspertë me reputacion ndërkombëtar në dy fusha, në atë për të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe në atë të arsimit. Rekomandimet e Hagës u sollën me qëllim që të mundësohet kuptim më i qartë i instrumenteve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e personave që u takojnë pakicave kombëtare në këtë fushë që ka rëndësi vitale për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e identitetit të personave që u takojnë pakicave kombëtare.

Instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut theksojnë se ato janë univerzale dhe se ato mund të gëzohen në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim. Mirëpo nënkuptohet se shumica e të drejtave të njeriut nuk janë absolute. Këto instrumente parashikojnë numër të kufizuar të situatave në të cilat shtetet arsyeshëm do të kufizonin zbatimin e disa të drejtave të caktuara. Kufizimet e lejuara nga ligji ndërkombëtar për zbatimin e të drejtave të njeriut përdoren në raste urgjente dhe në raste të kërcënimit të të drejtave dhe lirive të tjerëve, ose në situata kur kërcënohet morali publik, shëndetësia publike, siguria nacionale dhe mirëqenia e përgjithshme në një shoqëri demokratike¹. Sipas ligjit për të drejtat e njeriut, kufizimet e lirive duhet të interpretohen në mënyrë restriktive.

Të drejtat e personave që u takojnë pakicave kombëtare për të përdorë gjuhën e tyre publikisht dhe privatisht, siç janë parashtruar dhe elaboruar në Rekomandimet e Oslos Lidhur me të Drejtat Gjuhësore të Pakicave Kombëtare duhet të shihen në një kontekst të gjërë shoqëror. Rekomandimet nuk propozojnë një qasje izoluese, por të atillë e cila inkurajon ekuilibrin në mes të drejtës së personave që u takojnë pakicave kombëtare t'a ruajnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre, kulturën dhe gjuhën nga njëra anë, dhe nga ana tjetër nevojën për të siguruar se ata janë të aftë të integrohen më gjërë në shoqëri si anëtarë të njëjtë dhe të barabartë. Nga kjo perspektivë ky integrim nuk është i relizueshëm pa njohje të mirë të gjuhës ose gjuhëve zyrtare të shtetit. Rekomandimi për këtë shkollim implikohet në nenin 13 dhe 14 të **Konventës Ndërkombëtare për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore**, dhe në nenet 28 dhe 29 të **Konventës për të Drejtat e Fëmiut** e cila cek të drejtën për shkollim dhe e obligon shtetin t'a bëjë shkollimin e obligueshëm. Në të njëjtën kohë, neni 14(3) i **Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare** parashikon se mësimi i gjuhës

¹ Kufizimet e lartëpërmendura janë të përfshiera, p.sh., në provizionet vijuese:

Neni 30 Deklarata Univerzale për të Drejtat e Njeriut

Neni 19(3) Konvenca Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike

Neni 10(2) Konvenca Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale

së pakicave “duhet të implementohet pa paragjykime në mësimin e gjuhës zyrtare ose në ligjërimitin në këtë gjuhë”.

EMRAT

- 1) Neni 11 i **Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare** parashikon se personat që u takojnë pakicave kombëtare kanë të drejtë ta përdorin emrin e tyre personal, të babait të tyre dhe mbiemrin në gjuhën e vet. Kjo e drejtë e cila është esenciale për identitetin personal duhet të zbatohet në kuadër të rrethanave që janë tipike për çdo shtet. P.sh., autoritetet publike do të arsyetohen nëse përdorin transkripcionin në gjuhën zyrtare ose gjuhëve të shtetit për të mbajtur evidencë për emrat e personave që u takojnë pakicave kombëtare në formën e tyre fonetike. Nënkuptohej kjo duhet bërë në pajtim me sistemin gjuhësor dhe traditën e pakicës kombëtare në fjalë. Në kuadër të kësaj të drejte esenciale e lidhur ngushtë me gjuhën dhe identitetin e individëve, personat të cilët kanë qenë të detyruar nga autoritetet publike të heqin dorë nga emrat e tyre origjinal ose të paraardhësve të tyre si dhe të ndryshojnë ato kundër dëshirës së tyre, u jepet e drejta që t’i kthejnë emrat e tyre pa asnjë pagesë.
- 2) Emrat janë element i rëndësishëm edhe i identitetit të përbashkët sidomos te personat që u takojnë pakicave kombëtare të cilat veprojnë “në bashkësi”. Neni 2(1) i **Deklaratës të KB për të Drejtat e Personave që u takojnë Pakicave Kombëtare ose Etnike, Fetare dhe Gjuhësore** e proklamon të drejtën e personave që u takojnë pakicave kombëtare “ta përdorin gjuhën e tyre, privatisht dhe publikisht, lirisht dhe pa asnjë formë të diskriminimit”. Neni 10(1) i **Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare** i kushtëzon shtetet që t’u njohin të drejtën e personave që u takojnë pakicave kombëtare “t’u përdorin lirisht dhe pa pengesa gjuhën e tyre, privatisht dhe publikisht, gojarisht dhe në shkrim”. Neni 27 i **Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike** deklaron se ”personave që u takojnë... pakicave nuk do t’u mirret e drejta që në bashkësi me anëtarët tjerë të grupit të tyre... t’u përdorin gjuhën e tyre”. E drejta e personit t’u përdorë gjuhën e tij publikisht, në bashkësi me të tjerët dhe pa asnjë pengesë ose formë diskriminimi është tregues i fortë se trupat legal siç janë institucionet, asociacionet, organizatat ose ndërmarrjet e biznesit të themeluara dhe të drejtuara nga personat që u takojnë pakicave kombëtare kanë të drejtë t’i zgjedhin emrat në gjuhën e tyre. Ky emër i firmës duhet të njihet nga qeveria dhe të përdoret në pajtim me sistemin gjuhësor dhe traditat e bashkësisë në fjalë.

- 3) Neni 11(3) i **Konventës Kornizë** thotë se ”në vendbanimet tradicionalisht të banuara nga numër i madh i personave që i takojnë pakicës kombëtare, Partitë duhet të tentojnë... ti shfaqin emrat tradicional lokal, emrat e rrugëve si dhe rrëfyesit e tjerë topografik të parashikuar për përdorim publik në gjuhën e pakicave kur për këtë ka kërkesë të mjaftueshme”. Refuzimi për ta njohur validitetin e denominimeve historike të përshkruara më lartë mund të përbëjë tentativë për t’u reviduar historia dhe të asimilohen pakicat, duke paraqitur kështu kërcnim serioz për identitetin e personave që u takojnë pakicave.

FEJA

- 4) Neni 27 i **Konventës Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike** vërteton se “në shtetet ku egzistojnë pakica etnike fetare ose gjuhësore, personave që u takojnë atyre nuk duhet t’u merret e drejta që në bashkësi me anëtarët tjerë të grupit të tyre ta shfaqin dhe praktikojnë fenë e tyre, ose t’a përdorin gjuhën e tyre. Neni 3(1) i **Deklaratës të KB për të Drejtat e Personave që u takojnë Pakicave Nacionale ose Etnike, Fetare dhe Gjuhësore** kushtëzon se “personat që u takojnë pakicave mund t’i ushtrojnë të drejtat e tyre... individualisht si dhe në bashkësi me anëtarët tjerë të grupit të tyre, pa asnjë diskriminim”.

Besimi fetar dhe ushtrimi i fesë ”në bashkësi” është një fushë me rëndësi për shumë persona që u takojnë pakicave kombëtare. Prandaj vlen të theksohet se e drejta e deklarimit të fesë është e pakufizuar dhe e garantuar me nenin 18(1) të **Konventës Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike** dhe neni 9(1) i **Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale**. Mirëpo liria për ta manifestuar besimin fetar, duke përfshirë këtu edhe praktikën publike varet nga një numër i caktuar i kufizimeve të numëruara në pasuset ndihmës të artikujve të njejtë. Këto kufizime duhet të definohen me ligj dhe të jenë të lidhura me mbrojtjen e sigurisë publike, rendin, shëndetësinë, moralin dhe mbrojtjen e të drejtave fundamentale të tjerëve. Ato kufizime duhet të jenë të arsyeshme dhe proporcionale për ta arritur qëllimin, dhe shteti nuk duhet t’i përdorë ato me qëllim që t’i ngulfatë aspiratat legjitime shpirtrore gjuhësore ose kulturore të personave që u takojnë pakicave kombëtare.

Sa u përket pakicave ushtrimi i fesë është ngushtë i lidhur me ruajtjen e identitetit kulturor dhe gjuhësor. E drejta e përdorimit të gjuhës së pakicave në ritualet fetare publike është po aq jetike sa edhe e drejta për të themeluar

institucione fetare për ushtrimin e fesë. Që këtej, autoritetet publike nuk duhet të imponojnë kufizime të paarsyetueshme mbi ritualet publike fetare e as mbi përdorimin e cilës do gjuhë gjatë ritualit, pa marrë parasysh se a është kjo gjuha amtare e pakicës kombëtare në fjalë ose gjuha liturgjike e përdorur nga ajo bashkësi.

- 5) Aktet fetare siç janë martesat ose varrimet duhet gjithashtu të përbëjnë akte ligjore civile me të cilat do të vërtetohet statusi qytetar në disa shtete. Në këto raste, duhet marrë parasysh edhe interesi publik. Duke mos harruar parimin se rregullat administrative nuk duhet ta pengojnë realizimin e të drejtave të njeriut dhe se qeveria nuk duhet të imponojë kufizime gjuhësore mbi bashkësitë fetare. Kjo duhet të vlejë në mënyrë të barabartë për çdo lloj funksione administrative të ndërmarra nga bashkësitë fetare të cilat mund të përputhen me kompetencat e institucioneve qytetare. Atëherë shteti mund të kërkojë nga bashkësia fetare të mbajë evidencë për aktet ligjore qytetare për të cilat ai ka kompetenca gjithashtu edhe në gjuhën ose gjuhët zyrtare të shtetit ashtu që shteti pa pengese të kryejë funksionet regulluese dhe administrative.

JETA NË BASHKËSI DHE OJQ-e

- 6) Jeta kolektive e personave që u takojnë pakicave kombëtare, veprimtaria e tyre “në bashkësi” si është deklaruar në dokumentet ndërkombëtare vjen në shprehje në aktivitetet në fushat e shumta të veprimit. Aktivitetet i rëndësishëm është edhe ai i organizatave të tyre joqeveritare, asociacioneve dhe institucioneve që kanë domethënie vitale për ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të tyre. Kjo gjë vlerësohet si e dobishme dhe si motivim për zhvillimin e shoqërisë civile dhe vlerave demokratike në kuadër të shteteve.

Nenet 21 dhe 22 të **Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Politike dhe Civile** dhe neni 11 i **Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale** e garanton të drejtën e personave për tubim paqësor dhe lirinë për asociacion. E drejta e personave të veprojnë “në bashkësi” me anëtarët tjerë të grupit të tyre – e drejta e tyre të themelojnë dhe të udhëheqin organizata të tyre joqeveritare, asociacione dhe institucione – është një nga shtyllat e shoqërisë së hapur dhe demokratike. Neni 27-të i po të njejtës **Konventë** vërteton se “personave që u takojnë...pakicave nuk duhet t’u merret e drejta që në bashkësi me anëtarët tjerë të grupit të tyre, t’a... përdorin gjuhën e vet”. Duhet të jetë

rregull që qeveria nuk duhet të përzihet në punët e brendëshme të këtyre trupave „që veprojnë në bashkësi” e as të imponojë ndonjë kufizim përveç atyre që i lejojnë ligjet ndërkombëtare. Neni 17(2) i **Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare** në mënyrë të njejtë i angazhon shtetet që „mos të përzihen në të drejtën e personave që u takojnë pakicave kombëtare të marrin pjesë në aktivitetet e organizatave joqeveritare, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar“.

Neni 2(1) i **Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike** vërteton se çdo shtet e merr përgjegjësinë që t’u “sigurojë të gjithë individëve në territorin e tij të drejtat e njohura në këtë **Konventë** pa asnjë dallim si’ç është... gjuha“. Sipas këtij standardi, shtetet nuk duhet t’i diskriminojnë OJQ dhe në baza gjuhësore t’u imponojë kërkesa gjuhësore të pa arsyetuara. Prandaj autoritetet publike mund të kërkojnë nga këto organizata, institucione, organizata dhe asociacione që t’u përmbahen rregullave ligjore në baza të interesit legjitim publik duke përfshirë edhe përdorimin e gjuhës zyrtare të shtetit për komunikim.

Paragrafi 32.2 i **Dokumentit të Kopenhagës**, sa i përket finansimit vërteton se personat që u takojnë pakicave kombëtare kanë të drejtë „të themelojnë dhe të mbajnë institucione, organizata ose asociacione të tyre arsimore, kulturore dhe fetare të cilat mund të kërkojnë kontribute vullnetare financiare si dhe ndihmë publike në pajtim me ligjin“. Sipas kësaj, shteti nuk duhet t’i pengojë këta trupa që të kërkojnë ndihmë financiare nga buxheti shtetëror, nga burime ndërkombëtare publike si dhe nga sektori privat.

- 7) Në lidhje me finansimin shtetëror të aktiviteteve joqeveritare në mes tjerash në fushat sociale, kulturore ose sportive, zbatimi i parimeve të barazisë dhe jodiskriminimit kërkon nga autoritetet të sigurojnë pjesë proporcionale të finansimit të aktiviteteve të ngjajshme që zhvillohen në gjuhën e pakicave kombëtare që jetojnë në territorin e tyre. Në këtë kontekst, neni 2(1) i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike thekson se jo vetëm që nuk guxohet të bëhen dallime gjuhësore në trajtimin e individëve por me nenin 2(2) kërkohet që shtetet „të ndërmarrin hapa të nevojshëm... të sjellin ligje të atilla ose masa tjera që të realizohen të drejtat e njohura me... Konventën“. Pastaj, neni 2(2) i Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit Racor (që ka për qëllim të eliminojë çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë të bazuar në racë, ngjyrë, prejardhje, ose origjinë nacionale ose etnike) vërteton se „kur rrethanat lejojnë shteti duhet të ndërmarrë masa të veçanta dhe konkrete në

fushat sociale, ekonomike, kulturore dhe tjera për të siguruar zhvillim adekuat dhe mbrojtje të grupeve të veçanta racore ose individëve që u takojnë atyre, me qëllim që t'u garantojë të drejta të barabarta dhe të plota të njeriut dhe liri fundamentale...". Meqenëse gjuha është shpesh kriterium definues i etnicitetit e mbrojtur nga konventa e lartëpërmendur, bashkësitë e pakicave gjuhësore gjithashtu mund ta fitojnë të drejtën prej këtyre „masave të veçanta dhe konkrete“.

Në nivel evropian, paragrafi 31 i **Dokumentit të Kopenhagës** vërteton se “shtetet duhet të ndërmarrin masa të veçanta aty ku është e nevojshme, me qëllim që të sigurohet barazi e plotë e personave që u takojnë pakicave kombëtare me qytetarët e tjerë në realizimin e të drejtave të njeriut dhe lirive elementare“. Paragrafi 2 i nenit 4 i **Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare** e obligon shtetin „ që sipas nevojës të sjellë masa adekuate për të promovuar barazi të plotë dhe efektive mes personave që u takojnë pakicave kombëtare dhe shumicës, në të gjitha fushat e jetës: atë ekonomike, sociale, politike, dhe kulturore“; paragrafi 3 i të njëjtit nen më tutje specifikon se këto „masa nga paragrafi 2 nuk do të konsiderohen si akt diskriminimi“. Mëtej, neni 7(2) i **Marrëveshjes Evropiane për Gjuhët Regjionale ose të Pakicave** vërteton se „ sjellja e masave të veçanta në favor të gjuhëve regjionale ose të pakicave kanë për qëllim promovimin e barazisë në mes folësve të gjuhëve dhe pjesën tjetër të popullatës e cila ka konsideratë për kushtet e veçanta dhe nuk duhet të llogaritet si mënyrë e diskriminimit për folësit e gjuhëve në përdorim më të gjërë“. Prandaj, autoritetet publike duhet të sigurojnë pjesë të barabartë të financave nga buxheti shtetëror për aktivitete të personave që u takojnë pakicave kombëtare në mes tjerash fushat sociale, kulturore dhe sportive. Kjo përmbajtje mund të sigurohet nëpërmjet mjeteve ndihmëse, beneficioneve publike dhe lirimeve nga tatimi.

MEDIAT

- 8) Neni 19 i **Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike** i cili e garanton të drejtën e të menduarit si dhe të të shprehurit, është pikë kryesore për rolin dhe vendin e medimeve në shoqëri demokratike. Gjersa neni 19(1) thotë se „çdo kush ka të drejtë të mendimit pa përzjerje“, neni 19(2) vazhdon t'ia garantojë çdo kujt lirinë „të kërkojë të merr dhe të jep informacione dhe mendime të të gjitha llojeve, pa marrë parasysh kufizimet, qoftë në formë gojore, të shkruar ose në shtyp, në formë arti, ose nëpër medium sipas zgjidhjes“. Neni 10 i **Konventës Evropiane për**

Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale e garanton të drejtën për liri të shprehurit në mënyrë të ngjajshme. Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës në nenin 1 të **Deklaratës për Lirinë e të Shprehurit dhe Informimit** e shprehen „devotshmërinë e tyre të madhe ndaj parimeve të lirisë të shprehurit dhe informimit si element bazë për shoqëri demokratike dhe pluraliste“. Kështu këto shtete në të njëjtin dokument deklaruan se „në fushën e informacionit dhe mediave ato kërkojnë ta arrijnë... egzistimin e një shumëllojshmërie të mediave të pavarura dhe autonome, të cilat lejojnë shprehjen e shumëllojshmërisë të ideve dhe mendimeve“.

Neni 9(1) i **Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare** thotë qartë se personat që u takojnë pakicave kombëtare janë të lirë „të kenë mendime të veta dhe të pranojnë dhe këmbëjnë informacione dhe mendime në gjuhën e pakicës, pa përzierje nga autoritetet publike dhe pa marrë parasysh kufizimet...“. Mëtej, i njëjti koncept i obligon shtetet „në kuadër të sistemit të tyre ligjor të sigurojnë që personat që u takojnë pakicave kombëtare mos të jenë të diskriminuar sa u përket medimeve“. Neni 9(3) i **Konventës Kornizë** vërteton se shtetet, nuk do ta ndalojnë themelimin dhe përdorimin e shtypit nga personat që u takojnë pakicave kombëtare“. E njëjta gjë kërkon që „në kornizën ligjore të emitimit të radios dhe televizionit, shtetet të bëjnë sa më shumë, që personat që u takojnë pakicave të përfitojnë mundësinë e themelimit dhe përdorimit të mediave të tyre“. Gjithashtu duhet cekur se medime mund të themelojnë edhe trupat siç është parashikuar edhe në paragrafin 32.2 të **Dokumentit të Kopenhagës** i cili siguron të drejtën e personave që u takojnë pakicave kombëtare të „themelojnë dhe mbajnë institucionet, organizatat ose asocionet e tyre arsimore, kulturore dhe religjioze...“. Edhe pse mediat nuk citohen në këtë standard, ato luajnë rol esencial në promovimin dhe ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe identitetit.

Edhe pse nuk ka dyshim se personat që u takojnë pakicave kombëtare kanë të drejtë të themelojnë dhe të mbajnë media private, gjithashtu kjo e drejtë u nënshtrohet kufizimeve sipas ligjit ndërkombëtar si dhe kërkesave legjitime të rregullativave shtetërore në lidhje me mediat. Neni 9(2) i **Konventës Kornizë** e qartëson këtë duke potencuar lirinë e shprehur në nenin 9(1) të **Konventës** „se asgjë nuk duhet t’i ndalë palët në fjalë të fitojnë koncesion për ndërmarrje radiodifuzive dhe kinematografike pa diskriminim dhe në baza të kriteriumeve objektive“. Kushtet të cilat duhet të plotësohen nuk duhet të pengojnë gëzimin e kësaj të drejte.

- 9) Çështja e qasjes kah mediumet publikisht të finansuara është ngushtë e lidhur me konceptin e lirisë të të shprehurit. Neni 9(1) i **Konventës Kornizë** vërteton lirinë e të shprehurit të personave që u takojnë pakicave kombëtare duke përfshirë lirinë e këmbimit të informacioneve dhe ideve në gjuhën e pakicës, pa përzierje nga autoritetet publike dhe vazhdon me tekstin se „anëtarët e pakicave nuk duhet të diskriminohen në qasjet e tyre të mediave“. Neni 9(4) i **Konventës Kornizë** vërteton se partitë „duhet të marrin masa adekuate që të mundësojnë qasje të mediave për persona që u takojnë pakicave kombëtare“. Kjo nënkupton faktin se pakica që përbëhet nga numër i madh i personave duhet të ketë qasje me kohë proporcionale të emitimit, në radio ose televizionin shtetëror, duke marrë parasysh strukturën numerike të pakicës në pyetje gjatë ndarjes së kohës së emitimit.

Forca dhe koncentrimi numerik i popullatës nuk mund të llogariten si kriterium i vetëm gjatë ndarjes së kohës së emitimit për cilën doqoftë pakicë. Në raste të bashkësive më të vogla, duhet të merret parasysh koha minimale dhe mjetet pa të cilat pakica më e vogël nuk mund të paraqitet në medime.

Përveç kësaj, kualiteti i kohës për emitim që i është caktuar pakicës është çështje që kërkon qasje në mënyrë të arsyeshme dhe jodiskriminuese. Orët e caktuara për programet në gjuhën e pakicave duhet të sigurojnë se personat që i takojnë pakicës të kënaqen me programin në gjuhën e tyre që emitohet në mënyrë të kualitative. Prandaj, autoritetet publike duhet të sigurojnë që ky program të emitohet në pjesë të duhur të ditës.

- 10) Në një shoqëri të hapur dhe demokratike përmbajtja programore e medimeve nuk duhet të jetë e censuruar nga autoritetet publike pa arsye. Liria e të shprehurit e garantuar me nenin 19(1) të **Konventës Ndërkombëtare për tër Drejtat Civile dhe Politike** dhe neni 10(1) i **Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale** është me rëndësi në këtë drejtim. Restriksionet eventuale të imponuara nga autoritetet publike duhet të jenë në pajtim me nenin 19(3) të **Konventës** e cila vërteton se këto restriksione „do të përputheshin me ligjin kur do të ketë nevojë a) për të respektuar të drejtat dhe reputacionin e të tjerëve dhe b) për mbrojtjen e sigurisë shtetërore ose rendit publik dhe moralin“. Neni 10(2) i **Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale** parasheh kufizime identike në çdo ndërhyrje nga autoritetet publike që ka të bëjë me lirinë e të shprehurit.

Duhet përdorur mekanizma për të siguruar se programet e mediave publike të zhvilluara nga pakicat kombëtare i reflektojnë interesat dhe dëshirat e anëtarëve të bashkësisë dhe për ta ai është i pavarur. Prandaj pjesëmarrja e personave që u takojnë pakicave kombëtare në procesin editorial do të kalojë rrugë të gjatë për të siguruar ruajtjen e natyrës së pavarur të mediave e cila do t'u përgjigjet kërkesave të bashkësisë të cilës i shërben.

Në pajtim me parimin e barazisë dhe jodiskriminimit, përmbajtja e institucioneve publike duhet ta reflektojë përmbajtjen e popullatës së cilës ajo i shërben. Kjo gjithashtu vlen edhe për mediat publike. Neni 15 i **Konventës Kornizë** i obligon shtetet të „krijojnë kushtet e nevojshme për pjesëmarrje efektive të personave që u takojnë pakicave kombëtare në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike dhe në çështjet publike që kanë të bëjnë me to”. Neni 2 i **Organizatës Ndërkombëtare të Punës No. 111 në Lidhje me Diskriminimin gjatë Punësimit dhe Orientimit Profesional** në mënyrë më eksplicite i obligon shtetet të “udhëheqin politikë për t'i promovuar... mundësitë dhe trajtimin e barabartë në punësim dhe orientim profesional dhe për të eliminuar çdo lloj diskriminimi në këtë drejtim”. Punësimi jodiskriminues i personave që u takojnë pakicave kombëtare do të kontribuojë në objektivitetin e mediave.

- 11) Sipas nenit 19(2) të **Konventës Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike** dhe neni 9(1) i **Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare** dhe sipas parimit të jodiskriminimit emitimi i programeve nga shtetet tjera në gjuhën e pakicave nuk duhet të merret si shakas për shkurtrimin e kohës së programeve në gjuhën e pakicave.

Qasja ndërkufitare informimit dhe rrjetat mediale janë element esencial për të drejtën e informimit, e cila në kontekst të progresit të shpejtuar teknologjik, ka rëndësi gjithnjë e më të madhe. Rrjedhimisht kur p.sh. bëhet fjalë për dhënje të koncesionit për televizion kablovik, nuk është e ligjshme nëse shteti refuzon t'u japë koncesion stacioneve televizive ose të radios që gjenden në “shtetin simotër” edhe pse egziston interes qartë i theksuar nga ana e pakicës në fjalë për t'i ndjekë këto stacione. Kjo e drejtë vlen jo vetëm për mediumet kablovike por edhe për rrjetat informative elektronike në gjuhën e pakicës kombëtare.

Si çështje të përgjithshme, shtetet anëtare të Këshillit të Evropës në nenin III(c) të **Deklaratës për Liri të të Shprehurit dhe Informacionit** vendosën “të promovohet rrjedha e lire e informacioneve, duke kontribuar kështu në mirëkuptim ndërkombëtar, në njohuri më të mirë të bindjeve dhe

traditave, respekt për dallimin në mendime dhe pasurim të përbashkët të kulturave”. Në lidhje me kontaktet mediale ndërkufitare, shtetet duhet të harmonizojnë këto parime me këto nene.

JETA EKONOMIKE

- 12) Instrumentet ndërkombëtare merren shumë pak me të drejtat e personave që u takojnë pakicave kombëtare në fushën e veprimtrisë ekonomike. Mirëpo ato dokumente e përmendin të drejtën e pakicave kombëtare për përdorim të gjuhës së tyre publikisht dhe privatisht, lirë dhe pa asnjë formë diskriminimi, në formë gojore dhe të shkruar, individualisht dhe me të tjerët. Neni 19(2) i **Konventës Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike** dhe neni 10(1) i **Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Drejtave Fundamentale** e garanton të drejtën e të shprehurit jo vetëm duke respektuar idetë dhe mendimet që mund t’u transmetohen të tjerëve (respektivisht përmbajtja e komunikimit) por gjithashtu në lidhje me gjuhën si mënyrë për komunikim. Këto të drejta, sëbashku me të drejtën për barazi dhe jodiskriminim, e implikojnë të drejtën e personave që u takojnë pakicave kombëtare ta udhëheqin biznesin e tyre në gjuhën të cilën ata e zgjedhin. Për shkak të rëndësisë së pronarëve privat dhe të aftësisë së tyre për të komunikuar në mënyrë efikase me klientët e tyre si dhe t’i ndjekin iniciativat e tyre në kushte të barabarta, nuk duhet të egzistojnë kufizime të paarsyeshme për zgjidhjen e gjuhës.

Neni 11(2) i **Konventës Kornizë** vërteton se „çdo person që i takon pakicës kombëtare ka të drejtë të shpallë në gjuhën e tij të pakicës shenja, mbishkrime dhe informacione tjera të natyrës private në vend publik”. Në **Konventën Kornizë** shprehja “e natyrës private” nënkupton të gjitha ato që nuk janë zyrtare. Prandaj, shteti nuk duhet të imponojë asnjë kufizim në zgjedhjen e gjuhës në administrimin e ndërmarrjeve të biznesit privat.

Pa marre parasysh të lartpërmendurën, shteti mund të kërkojë që gjuha zyrtare ose gjuhët e shtetit të aftësohen në ato pjesë të aktivitetit ekonomik që ndikojnë mbi realizimin e të drejtave e të tjerëve ose nënkuptojnë këmbim dhe komunikim me trupat publik. Kjo rrjedh nga restriktionet e lejueshme për lirinë e të shprehurit si është vërtetuar në nenin 19(3) të **Konventës Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike** dhe neni 10(2) i **Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave Njerëzore dhe Lirive Fundamentale**. Gjersa kufizimet e lejuara të cekura në këto akte do të kishin mundur të nënkuptojnë arsyetim për kufizimet e

përmbajtjes së komunikimit, ato asnjëherë nuk do të kishin paraqitur arsyetim për kufizimin e përdorimit të gjuhës si mënyrë për komunikim. Nënkuptohej, mbrojtja e të drejtave dhe e lirive e të tjerëve dhe kërkesat e kufizuara të administratës publike mund të jetë arsyetim për udhëzime të veçanta për përdorim plotësues të gjuhës zyrtare ose gjuhëve të shtetit. Kjo do të përkonte me aktivitetet siç janë mbrojtja dhe siguria shëndetësore në vendin e punës, mbrojtja e konsumuesve në raportet e punës, tatimi, raportet financiare, sigurimi shëndetësor, sigurimi i të papunësuarve, transporti etj. Sipas interesit legjitim publik, shteti mundet krahas përdorimit të cilës do gjuhë tjetër, gjithashtu të kërkojë përdorimin edhe të gjuhës zyrtare ose gjuhëve të shtetit, në ato aktivitete biznesi siç janë përcaktimi dhe emërtimi në vende publike, siç është theksuar në paragrafin 60 të **Raportit Sqarues të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare**. Shkurtimisht, shteti nuk mundet asnjëherë ta ndalojë përdorimin e gjuhës, por ai mundet në bazë të interesit të arsyetuar publik të jep udhëzime për përdorim plotësues të gjuhës zyrtare ose gjuhëve të shtetit.

Sipas logjikës së njejtë të interesit të arsyetuar publik, kushtet eventuale për përdorimin e gjuhës të caktuara nga shteti do të jenë në raport proporcional me interesin publik të cilit i shërbejnë. Proporcionaliteti në këtë kërkesë duhet të caktohet gjer në atë shkallë në të cilën nevojitet. Rrjedhimisht sipas kësaj në interesin publik të sigurisë dhe mbrojtjes shëndetësore në vendin e punës, shteti mund të kërkojë përveç fabrikave private edhe ato shtetërore të nxjerin paralajmërime në gjuhë zyrtare ose në gjuhë të shtetit krahas gjuhës të zgjedhur të ndërmarrjes. Në mënyrë të ngjajshme, në interes të udhëheqjes së administratës publike në lidhje me tatimin, shteti duhet të kërkojë që formularët administrativ të plotësohen në gjuhën zyrtare ose gjuhët e shteteve dhe të kërkojë në rast revizioni nga ana e autoriteteve publike, dokumentacioni relevant të jetë i shkruar edhe në gjuhën zyrtare ose në gjuhët e shtetit; në rastin e dytë nuk duhet të kërkohej nga ndërmarrjet private t'a zhvillojnë tërë evidencën e tyre në gjuhën ose gjuhë të shtetit, por shpenzimet për përkthimin eventual i mban ndërmarrja private. Kjo është pa paragjykitime për të drejtën e fituar të anëtarëve të pakicave kombëtare për ta përdorë gjuhën ose gjuhët e tyre në komunikimet me autoritetet administrative siç është parashikuar në nenin 10(2) të **Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare**

AUTORITETET ADMINISTRATIVE DHE SHËRBIMET PUBLIKE

13/14/

- 15) Shtetet anëtare të OSBE-së janë obliguar të marrin masa për të kontribuar në krijimin e rrethit jetësor dinamik, të hapur jo vetëm për mirëmbajtjen e identitetit të personave që u takojnë pakicave kombëtare (duke e përfshirë edhe gjuhën e tyre) por gjithashtu edhe zhvillimin dhe përparimin e tyre. Rrjedhimisht, këto shtete janë obliguar ta respektojnë “të drejtën e personave që u takojnë pakicave kombëtare në pjesëmarrjen e tyre efektive në çështjet publike” si është nënvizuar në paragrafin 35 të Dokumentit të Kopenhagës. Neni 10(2) i Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare kërkon haptazi nga shtetet që të “mundësojnë përdorimin e gjuhëve të pakicave në komunikimet me autoritetet administrative”. Paragrafi 35 i Dokumentit të Kopenhagës gjithashtu shpreh mundësinë e krijimit të ambientit jetësor i cili do të jetë i hapur për pakicat kombëtare në çështjet publike, në gjuhën e tyre, duke themeluar “administrata adekuate lokale ose autonome që do të korespondojnë me rrethanat specifike historike dhe territoriale të pakicave në pajtim me politikën e shtetit në fjalë”. Neni 15 i Konventës Kornizë i obligon shtetet të „krijojnë kushte të nevojshme për pjesëmarrje efektive të personave që u takojnë pakicave kombëtare në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike dhe në çështjet publike, sidomos ato që i tangojnë”. Këto përcaktime i obligojnë autoritetet publike t’u mundësojnë personave që u takojnë pakicave kombëtare të komunikojnë me autoritetet lokale në gjuhën e tyre ose të marrin vërtetime qytetare dhe leje në gjuhën e tyre. Sipas parimeve të barazisë dhe të jodiskriminimit, këto përcaktime gjithashtu nënkuptojnë lidhje dinamike të pjesëmarrjes me ç’rast gjuha e pakicës mund të bëhet mjet i plotfuqishëm në jetën lokale politike dhe në raportet e ndërsjella mes qytetarëve dhe autoriteteve publike duke e përfshirë këtu dhe përdorimin e shërbimeve publike.

Përfaqësimi etnik në institucionet administrative dhe në agjencitë që janë themeluar për t’i shërbyer popullates reflekton shoqëri pluraliste të hapur dhe jodiskriminuese. Me qëllim që të eliminohen efektet e diskriminimit të kaluar ose atij egzistues në sistem, neni 2 i **Konventës No. 111 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës në Lidhje me Diskriminimin gjatë Punësimit dhe Orientimin Profesional** i obligon shtetet që të “udhëheqin politikë kombëtare për të promovuar...barazinë të mundësive dhe trajtimin e barabartë gjatë punësimit dhe orientimit profesional, me qëllim që të eliminohet çdo diskriminim në këtë fushë”.

Kur themelohen dhe implementohen programe dhe shërbime për opinionin, është reale të pritët se qeveritë që u janë nënshtruar parimeve të lartëpërmendura duhet ta marrin parasysh dëshirën e shprehur nga personat që u takojnë pakicave kombëtare si dhe parimin e justifikimit numerik. Kur shprehet nevoja dhe numri është i madh, parimi i barazisë kërkon që tatimpaguesit që u takojnë pakicave kombëtare t'u qasen shërbimeve në gjuhën e tyre. Kjo në veçanti vlen në rastet e shërbimeve shëndetësore dhe sociale të cilat ndikojnë në kualitetin e jetës së njerëzve në mënyrë të shpejtë dhe esenciale.

Sipas parimeve të barazisë dhe jodiskriminimit, autoritetet administrative duhet të sillen me personat që u takojnë pakicave kombëtare në mënyrë të gjithanshme dhe të barabartë. Shtetet duhet ta pranojnë realitetin demografik të regjioneve që janë nën kompetencat e tyre. Mbi të gjitha, shtetet nuk duhet t'u largohen obligimeve të tyre duke ndryshuar realitetin demografik të regjionit. Neni 16 i **Konventës Kornizë** në mënyrë specifike i obligon shtetet të përmbahen nga masat që do ta kishin ndryshuar proporcionin e popullatës në vendet e banuara nga persona që u takojnë pakicave kombëtare me qëllim që të kufizohen të drejtat e këtyre pakicave. Këto masa mund të përmbajnë shpronësime, shpërngulje me dhunë si dhe ridefinim të kufinjëve administrativ dhe manipulim me regjistrimin e popullatës.

INSTITUCIONET E PAVARURA NACIONALE

- 16) Të drejtat e njeriut e arrijnë kuptimin e tyre të vërtetë kur autoritetet publike të shtetit themelojnë mekanizma për të siguruar se të drejtat e garantuara në konventat dhe deklaratat ndërkombëtare ose në legjislacionin vendor janë të zbatuara dhe të mbrojtura në mënyrë efektive. Si plotësim i procedurave juridike, institucionet e pavarura nacionale sigurojnë burime më të shpejta dhe më të lira dhe janë më të kapshme.

Diskriminimi i përmendur në **Konventën për Eliminimin e Diskriminimit Racor** nuk është i definuar sipas kriterëve të lidhura ngushtë me racën. Neni 1(1) i **Konventës** vërteton se koncepti i diskriminimit racor nënkupton "çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë e bazuar në racë, ngjyrë prejardhje ose origjinë nacionale ose etnike e cila ka për qëllim nënçmimin ose injorimin e njohjes, realizimin dhe përdorimin në baza të barazisë të të drejtave njerëzore dhe lirive fundamentale në fushat politike, ekonomike, sociale, kulturore të jetës

publike”. Neni 6 i **Konventës** deklaron se organet shtetërore duhet t’i sigurojnë çdokujt në kuadër të kompetencave të tyre, mbrojtje dhe dëmshpërblime nëpërmjet gjykatave nacionale kompetente dhe institucioneve të tjera shtetërore kundër çdo akti të diskriminimit racor të cilët i shkatërrojnë të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale që janë të kundërta me këtë Konventë...”. Kështu themelimi i institucioneve të pavarura nga shteti që mund të veprojnë si mekanizma për kompenzim, siç janë institucioni i Avokatit Popullor ose Komisioni për të Drejtat e Njeriut paraqesin natyrën demokratike dhe pluraliste të një shteti. Rrjedhimisht sipas **Rezolutës 48/134 të 20 dhjetorit 1993 të Kombeve të Bashuara**, **Këshilli i Evropës ka inkurajuar në Rekomandimin No. R(97) 14 në 30 shtator 1997 të Këshillit të Ministrave**, themelimin e “institucioneve për të drejtat e njeriut, në veçanti komisionet që janë pluraliste në përbërje, Avokatin Popullor e tjera”. Këta mekanizma për kompenzim duhet të jenë të kapshëm gjithashtu për persona që u takojnë pakicave kombëtare të cilët konsiderojnë se të drejtat e tyre gjuhësore dhe të tjera janë të rrezikuara.

ORGANET GJYGJËSORE

17/18) Sipas së Drejtës Ndërkombëtare, organet kompetente duhet që të gjithë personat që janë të arrestuar të akuzuar dhe të gjykuar, ti informojë për aktet e ngritura kundër tyre dhe për të gjitha procedurat tjera në gjuhën që e kuptojnë. Sipas nevojës duhet të ketë përkthyes pa pagesë. Ky standard i procesit të obligueshëm ligjor është univërsal në përdorimin e tij dhe nuk ka të bëjë me të drejtat gjuhësore të pakicave kombëtare. Këtu janë më të rëndësishme parimet e barazisë dhe jodiskriminimit para ligjit. Këto parime kanë rol vital kur bëhet fjalë për akuza dhe procedura penale. Rrjedhimisht, neni 14(3)(a) i **Konventës Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike** kërkon që çdokush që është i paditur për vepër kriminale duhet të jetë “i informuar menjëherë dhe në detaje në gjuhën që e kupton, për natyrën dhe arsyen e akuzës së ngritur kundër tij”. Neni 6(3)(a) i **Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Liritë Fundamentale** vërteton të njëjtat kërkesa në të njëjtën gjuhë. Përveç kësaj, neni 5(2) nga konventa e lartëpërmendur i vërteton kërkesat e njejta me lidhje me arrestin. Mëtej, neni 14(3) i **Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike** e përcakton të drejtën e çdokujt që në “barazi të plotë”... “(e) t’i egzaminonjë, ose t’i ketë egzaminuar, dëshmitarët kundër tij dhe ta fitojë të drejtën për prezencë dhe egzaminim të dëshmitarëve në emër të tij në të njëjtat kushte si dëshmitar kundër tij”. Në këtë drejtim, neni 14(3)(f) i **Konventës Ndërkombëtare**

për të Drejta Politike dhe Civile dhe neni 6(3)(e) i **Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale** i'a garantojnë të drejtën çdokujt që “të ketë përkthyes pa pagesë nëse nuk mund ta flasë ose ta kuptojnë gjuhën e përdorur në gjyq”. Gjersa këto garanca kanë të bëjnë kryesisht me gjuhën që përdoret në procedurat penale, ato burojnë nga garancat fundamentale për barazi para gjykatave dhe tribunaleve siç është cekur në nenin 14(1) të **Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike** ku parashihet se procedurat ligjore nga cili do lloj duhet të konsiderohen në mënyrë të përkryer fer, deri në atë shkallë në të cilën do të arrihen kushte të barabarta për të gjithë. Ky përcaktim që vlen në mënyrë të barabartë me respektimin e zgjedhjes së gjuhës për procedura në përgjithësi, duhet t'u shërbejë shteteve si rrëfyes për politikë të barabartë dhe efikase në administrimin e të drejtës.

Më përgjithësisht neni 7(1) i **Marrëveshjes Evropiane për Gjuhë Regjionale ose të Pakicave** deklaron se shtetet duhet ta bazojnë politikën e tyre, legjislacionin dhe praktikën në qëllime dhe parime si “njohjen e gjuhëve regjionale ose të pakicave si pasuri kulturore...” dhe “nevojën për veprim këmbëngulës për t'i përparuar gjuhët regjionale ose të pakicave me qëllim që t'i mbrojë ato”. Neni 7(4) i **Marrëveshjes Evropiane** vërteton se “në përcaktimin e politikës së tyre në lidhje me gjuhët regjionale dhe të pakicave, organet shtetërore duhet t'i marrin parasysh nevojat dhe dëshirat e grupeve që i përdorin ato gjuhë. Neni 15 i **Konventës Kornizë** i obligon shtetet që të „krijojnë kushte të nevojshme për pjesëmarrje efektive në jetën kulturore sociale dhe ekonomike dhe në çështjet publike në veçanti ato të lidhura me ta”. Nëse mirren parasysh standardet e lartpërmendura sëbashku me qasjen adekuate të drejtësisë për shoqëri demokratike atëherë është e arsyeshme që nga shtetet të pritet sigurimi i së drejtës të personave që u takojnë pakicave kombëtare, të shprehen në gjuhën e tyre në të gjitha fazat e procedurave gjyqësore “qoftë penale, civile ose administrative” dhe njëkohësisht të respektohen të drejtat e të tjerëve dhe të mbahet integriteti i proceseve, duke përfshirë këtu edhe procedurat e ankesave të dorëzuara.

- 19) Meqenëse e drejta për drejtësi ka kuptim vital për realizimin e të drejtave të njeriut, shkalla në të cilën mund të mirret pjesë në mënyrë direkte dhe të lehtë në procedurat në dispozicion është masë e rëndësishme për këtë qasje. Prandaj dispozicioni i procedurave juridike që funksionojnë në gjuhën e personave që u takojnë pakicave kombëtare e bën këtë qasje më të lehtë dhe më direkte për këta persona.

Prandaj, neni 9 i **Marrëveshjes Evropiane për Gjuhët Regjionale ose të Pakicave** përcakton se, gjer te shkalla që i përgjigjet kërkesës të njëjës nga palët në fjalë, të gjitha procedurat juridike duhet të zhvillohen në gjuhën regjionale ose të pakicës. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ka ardhur deri në përfundim të njëjtë në nenin 7(3) të **Rekomandimit 1201** i cili siguron se “në regjionet ku jeton numër i madh i personave të pakicës kombëtare, ata kanë të drejtën ta përdorin gjuhën amtare në kontaktet e tyre me autoritetet administrative dhe në procedurat para gjyqit dhe autoriteteve ligjore”. Sipas kësaj shtetet duhet të kenë kuadër adekuat dhe politikë trajtimi në fushën e jurisprudencës.

PRIVIMI NGA LIRIA

- 20) Rregulla 51, paragrafi 1 dhe 2 i **Rregullave të Kombeve të Bashkuara për Standarde Minimale për Trajtimin e të Burgosurve** si dhe rregulla 60, paragrafet 1 dhe 2 të **Rregullave të Këshillit të Evropës për Rregullat të Burgut** e theksojnë rëndësinë e të drejtës të të burgosurve të kuptohen nga administrata e burgut si dhe rëndësia për administratën e burgut t’i kuptojë të burgosurit. Këto përcaktime si të këtilla nuk u përkasin të drejtave të pakicave. Mirëpo nëqoftëse merren parasysh sëbashku me dëshirën e shprehur të grupeve në fjalë, pjesëmarrjen e tyre numerike dhe parimin e barazisë dhe jodiskriminimit, përcaktimet e lartpërmendura janë më të rëndësishme në regjionet ose lokalitetet ku personat që u takojnë pakicave kombëtare janë të pranishëm në numër të madh.
- 21) Rregulla 37 e **Rregullave të Kombeve të Bashkuara për Standarde Minimale** si dhe neni 43(1) i **Rregullave të Këshillit të Evropës për Rregullat të Burgut** e mbajnë të drejtën që të burgosurit të komunikojnë me familjet e tyre, me shokët e tyre dhe me përfaqësues të organizatave të jashtme. Për shkak të rëndësisë të këtyre të drejtave të njeriut siç është liria e të shprehurit dhe e drejta për të përdorur gjuhën e tij publikisht dhe privatisht është detyrë e autoriteteve t’i respektojnë këto të drejta në kuadër të kufizimeve të parashikuara me ligj qoftë edhe në institucionet për vuajtje të dënimit. Si rregull, të burgosurit duhet të kenë të drejtë të komunikojnë në gjuhën e tyre si gojarisht me të burgosurit e tjerë dhe vizituesit ashtu edhe në korespondencën personale. Sidoqoftë disa të drejta të caktuara dhe liri të personave të burgosur për vepra penale mund të jenë arsyeshëm të kufizuara për shkak të sigurisë publike në pajtim me kufizimet të parashikuara me dokumentet ndërkombëtare. Për arsye praktike, realizimi i

të drejtave gjuhësore i të burgosurve më së miri mund të mundësohet në se ata gjenden në burg në vendin ku zakonisht flitet gjuha e tyre.